

**FJALIM I PËRFAQËSUESIT SPECIAL TË SEKRETARIT TË
PËRGJITHSHËM DHE SHEFIT TË UNMIK-ut
NË KËSHILLIN E SIGURIMIT**

**Nju Jork
7 shkurt 2019**

Z. President, anëtarë të shquar të Këshillit,

1. Ashtu siç është paraqitur në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, kjo periudhë e fundit është karakterizuar me veprime dhe retorikë që në përgjithësi nuk e ka përmirësuar atmosferën për një vazhdim të menjëhershëm të dialogut politik në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Veprimet dhe akuzat antagoniste vazhdojnë të jenë shumë më të dukshme se sa përpjekjet për t'u kthyer në fazën e re të dialogut, i cili është diskutuar gjerësisht për shumë muaj tani.

2. Padyshim, liderët e të dyja palëve po përballen me sfida serioze. Mirëpo, kushti minimal për vazhdimin e dialogut është të gjendet mënyra për një atmosferë të qëndrueshme dhe jo të trazuar. Përkundrazi, ka pas tendencë të keqësohet dhe jo të ulet tensioni i gjendjes. Mungesa e një pozicioni të unifikuar në Prishtinë për kushtet e vazhdimin të dialogut me Beogradin ka arrit pikën kritike në ditët që nga përmbyllja e periudhës raportuese, duke ngritur shqetësime për qëndrueshmërinë në vazhdimësi të koalicionit aktual qeverisës në Kosovë.

3. Ku e çon kjo perspektivën për një angazhim konstruktiv politik? Shumë vëmendje i është kushtuar tarifës prej 100 për qind të vendosur nga autoritetet e Prishtinës në fillim të nëntorit vitin e kaluar, për mallrat me prejardhje nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kjo masë është kundërshtuar nga shumë qarqe dhe Beogradi ka kërkuar revokimin e tarifës nga Prishtina për mundësimin e dialogut. Prishtina e ka lidh heqjen e tarifës me një numër

kushtesh. Ky nuk është shembulli i vetëm i pozicionit të palëve që komplikon përpjekjet për t'u kthyer në tavolinën e negociatave.

4. Një qasje e përgjegjshme dhe largpamëse është esenciale për largimin e pengesave për të rifilluar negociatat politike. Në dhjetor, në Prishtinë u themelua një ekip i zgjeruar negociator për dialogun, që përfshin anëtarë të Kuvendit të Kosovës. Mirëpo, diskutimet e brendshme për parimet kyçe për të drejtuar pozicionin e Prishtinës në negociatat e ardhshme ende vazhdojnë. Në të njëjtën kohë, më shumë duhet bërë në të dyja anët për të përgatitur terrenin për çfarëdo marrëveshje që mund të arrihet në mes të palëve. Kjo do të kërkonte një angazhim më aktiv me një grup të gjerë të palëve të interesuara dhe përkrahjen e tyre, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e plotë, të barabartë dhe kuptimplote të grave në procesin e ndërlidhur me dialogun, dhe marrjen parasysh të perspektivës gjinore.

Z. President,

5. Në dhjetor, Kuvendi i Kosovës miratoi tre ligje që kanë të bëjnë me sjelljen dhe aktivitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ligjet nuk u mbështetën nga grupi i deputetëve serbë dhe u kritikuan shumë nga Beogradi. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) parasheh kornizën ligjore për praninë ndërkombëtare të sigurisë, Forcën e Kosovës (KFOR-in), të cilit i është besuar përgjegjësia për të siguruar një ambient të qetë e të sigurt në Kosovë. KFOR-i e ka përsëritur këtë pozicion, duke potencuar se çfarëdo ndryshimi duhet të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës, dhe të gjitha zotimet e përparshme të Prishtinës lidhur me FSK-në vazhdojnë të respektohen.

6. Zhvillimet e fundit në marrëdhëniet në mes të Prishtinës dhe Beogradit i kanë vështirësuar përpjekjet për krijimin e një atmosfere të favorshme për dialog dhe kompromis në mirëbesim. Kjo na kujton që, po aq sa zotimet e nivelit më të

lantë janë qendrore është edhe përkushtimi për ndërtimin e mirëbesimit të ndërsjellë dhe besimit në mes të komuniteteve në terren.

7. Për t'i kontribuar në mënyrë efektive këtij aspekti të rëndësishëm të normalizimit dhe pajtimit, puna e UNMIK-ut është përqendruar në mundësimin e kontakteve në mes njerëzve në Kosovë. Së bashku me ekipin e Kombeve të Bashkuara për Kosovë dhe me partnerët tjerë ndërkombëtarë, UNMIK-u përkrah implementimin e rekomandimeve të përbashkëta të Forumit të Kombeve të Bashkuara për ndërtimin e besimit, të mbajtur në maj të vitit 2018 në Lubjanë, duke u përqendruar në mbështetjen e aktiviteteve në sektorët dhe shtresat e ndryshme të shoqërisë. Këto përfshijnë dialogun në mes të komuniteteve, mbështetjen e të drejtave gjuhësore dhe barazisë para ligjit, fuqizimin e rinisë dhe barazisë gjinore. Në bashkëpunim me ekipin e Kombeve të Bashkuara për Kosovë, Misioni ka angazhuar edhe shoqërinë civile të Kosovës për të ndihmuar në uljen e diskriminimit në baza gjinore dhe etnike. UNMIK-u ka shfrytëzuar maksimalisht resurset e tij të kufizuara me kombinimin e përpjekjeve me partnerët tanë ndërkombëtarë.

8. UNMIK-u po ashtu vazhdoi me mbështetjen e implementimit të iniciativave dhe legjislacionit që lidhen me të drejtat e njeriut, të cilat shpesh bëhen më të vështira me financime joadekuate dhe me zotime të tjera të resurseve. Përparim i rëndësishëm është bërë në punën e “Grupit punues për persona të pagjetur”. Kjo punë duhet të jetë e papenguar nga ndikimet politike në mënyrë që të mbahet dinamika për këtë çështje, që është thelbësore për pajtim afatgjatë. Më shumë duhet bërë për të garantuar efektivisht të drejtat e komuniteteve joshumicë, duke përfshirë ashkalitë, egjiptianit dhe romët, si dhe të kthyerit dhe personat e zhvendosur brenda vendit.

9. Përkrahja e barazisë së vërtetë gjinore në Kosovë është një fushë tjetër që meriton vëmendje të veçantë. Unë tanimë e kam theksuar nevojën për

perspektiva gjinore në dialog. Për këtë pjesë, UNMIK-u mbështet iniciativat për ndërtimin e shkathtësive sipërmarrëse të grave dhe përkrahë gratë në fillimin e bizneseve të reja. Unë kam qenë i angazhuar drejtpërsëdrejti me gra lidere në nivele qendrore dhe lokale për të përkrahur iniciativat e tilla, dhe unë besoj se ndjehet një rritje e fuqizimit. UNMIK-u, në partneritet me akterë të tjerë të KB-së, mbështet institucionet e nivelit lokal të Kosovës në rehabilitimin dhe re-integrimin e viktimave të dhunës në familje. Misioni ka kontribuar në disa iniciativa të përkrahjes me synimin e parandalimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave, në kuadër të kornizës së 16 ditë të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore. Gjatë kësaj fushate, në Prishtinë u paraqit dokumentari i punuar nga UNMIK-u “Nuk është prona jote”, që u pasua me shfaqjen e tij në dhjetë komuna të Kosovës, të organizuar në bashkëpunim me UN-Women dhe të drejtuar nga autoritetet lokale dhe partnerët e shoqërisë civile. Ky dokumentar paraqet tregime të viktimave të mbijetuar nga mbarë komunitetet e Kosovës, dhe intervista me ekspertë se si posedimi jashtëzakonisht i ulët i pronave nga gratë për shkak të normave zakonore, i bën gratë të cenueshme ndaj dhunës në familje.

10. Në përkrahjen e ndërtimit të besimit në mes të komuniteteve, UNMIK-u u përqendrua në mënyrë të veçantë në fuqizimin e rinisë. Në muajt e fundit, UNMIK-u është bërë partner me dy organizata joqeveritare të drejtuara nga të rinj, për implementimin e projekteve që synojnë nxitjen e pajtimit të qëndrueshëm përmes arsimimit mbi të drejtat e njeriut. UNMIK-u vazhdoi me përkrahjen e ekipeve shumetnike të liderëve të rinj në organizimin e aktiviteteve të ndryshme që komuniteteve të tyre u sjellin ndryshime pozitive. UNMIK-u po ashtu mbështet bordet këshillëdhënëse të të rinjve në ngritjen e kapaciteteve të tyre për t'u angazhuar në dialogun në mes komuniteteve. Në janar, ekipi i KB-së për Kosovë, i përkrahur nga Fondi i KB-së për ndërtimin e paqes, inicioi një

projekt në bashkëpunim me UNMIK-un për të fuqizuar të rinjtë për një të ardhme paqësore, prosperuese dhe të qëndrueshme në Kosovë.

Z. President,

11. Perspektiva evropiane mbetet një stimulim i rëndësishëm për paqe dhe stabilitet në rajon. Është me rëndësi që liderët e Kosovës ta mbajnë fokusin në avancimin e iniciativave që janë esenciale për popullin e Kosovës, posaçërisht në fushën e sundimit të ligjit dhe antikorrupsionit , të drejtat e njeriut, fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe harmonizimin e legjislacionit me legjislacionin e BE-së dhe standardet tjera ndërkombëtare.

Z. President,

12. Më lejoni të theksoj rëndësinë e përkrahjes nga të gjithë anëtarët e Këshillit për aktivitetet në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Ulja e tensioneve, rritja e besimit të ndërsjellë dhe largimi i pengesave për dialog janë thelbësorë për stabilitet në rajon.

13. Unë i kam zotuar resurset e UNMIK-ut në përkrahjen e ndërtimit të besimit në të gjitha nivelet e shoqërisë kosovare, dhe ne do të vazhdojmë të përqendrohemi në këtë proces në bashkërendim të ngushtë me të gjitha organizatat tona partnere në terren. Ju falënderoj për mbështetjen tuaj dhënë këtij Misioni.